



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:258288

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753494

KE.nr.1393/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit “Hymeri Elevators” SH.P.K., me NRB:70452021, me seli në Prishtinë, rruga “Ahmet Krasniqi”, përfaqësuar sipas autorizimit nga shoqëria e avokatëve “Sejdiu & Qerkini” SH.P.K., kundër të paditurve 1. B.H., me vendbanim në Prishtinë, rruga “Ndue Përlleshi” 1/19, dhe 2. B.K., me vendbanim në Prizren, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës me datën 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE, për të vendosur sipas padisë së paditësit “Hymeri Elevators” SH.P.K., me numër të lëndës KE.nr.1393/22 të datës 21.11.2017, kundër të paditurve B.H. dhe B.K., me objekt kontesti kompensim dëmi.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi “Hymeri Elevators” SH.P.K., me datë 21.11.2017, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi kundër të paditurve B.H. dhe B.K., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit ashtu që të obligohen të paditurit që t’ia kompensojnë dëmin material me kamat ligjore nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës .

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë si dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Sipas nenit 13 par.1 nën par. 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale ( Ligji nr. 08/L-15) përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*.

Meqenëse në rastin konkret të paditurit janë persona fizik ndërsa Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale është kompetent për të vendosur kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate dhe duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1393/22, datë 29.05.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate